

VENDIM
Nr.571, datë 28.5.2009

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM,
TË KOMUNËS KRYEVIDH TË QARKUT TË TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të komunës Kryevidh të qarkut të Tiranës, sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ të komunës Kryevidh të qarkut të Tiranës, miratuar me vendimin nr.1420, datë 10.10.2008 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Kryevidh të qarkut të Tiranës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Kryevidh për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Kryevidh

Lidhja nr.1

Numrat rendor të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
8-21	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
22-29	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
31-40	Prona që përdoren në fushën e strehimit dhe mbrojtjes civile	Në pronësi
41-63	Varreza publike	Në pronësi
69,73,76,80,83,85,87,94, 98,99,112,113,114	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproduktive).	Në pronësi
108,109,110,111	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
115-580	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
581-592	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi